




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

KORAB R. SEJDIU
Deputet
Poslanik – Representative



Për / Za / For:	Z. Abelard Tahiri, Ministër Ministria e Drejtësisë
Nga / Od / From:	Korab R. Sejdiu, Deputet
Data / Datum / Date:	10 gusht 2018
Referenca / Referenca / Reference:	08/2018
Lënda / Predment / Subject:	Pyetje parlamentare për përgjigje me shkrim

Në bazë të Nenit 46 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, shtroj pyetje parlamentare për përgjigje me shkrim.

Çështja: Kohë më pare (mars 2018), keni publikuar fillimin e iniciativës për “Rishikimin Funkcional të Sektorit të Sundimit të Ligjit” në Kosovë. Lidhur me këtë keni mbajtur edhe një Konferencë, ku të ftuarit janë informuar lidhur me këtë iniciativë të Ministrisë së Drejtësisë.

PYETJA: Z. Ministër, tani që kanë kaluar disa muaj nga fillimi i kësaj iniciative, a mund të na tregoni se çka është ndërmarrë në këtë drejtim nga Ministria që ju drejtoni? Cili është plani i veprimit dhe çfarë orari të veprimit keni planifikuar për këtë sfidë? Kur pritni që ky rishikim të përfundojë? Çfarë rezultate pritni nga rishikimi (çka do të jetë produkti final) dhe a është pjesë e planifikuar e rishikimit edhe hartimi i një plani gjithëpërfshirës për reformë në sistemin e drejtësisë në Kosovë? Për më tepër, kush është i përfshirë në këtë rishikim kaq të madh dhe sfidues?



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

KORAB R. SEJDIU
Deputet
Poslanik – Representative

REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI REPUBLIKËS SË KOSOVËS
SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO
Zyra për Propozime dhe Përgjithësishtësi dhe për Përzgjedhje / Tablo Office
No. Propozime / Proposals: 06/1845/Do-1013
No. Propozime / Proposals: 06/1845/Do-1013
Date / Datum: 08/08.2018
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA

Për / Za / For:	Dr. Pal Lekaj, Ministër Ministria e Infrastrukturës
Nga / Od / From:	Korab R. Sejdiu, Deputet 
Data / Datum / Date:	8 gusht 2017
Referenca / Referenca / Reference:	07/2018
Lënda / Predment / Subject:	Pyetje parlamentare për përgjigje me shkrim

Në bazë të Nenit 46 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, shtroj pyetje parlamentare për përgjigje me shkrim.

Çështja: Kohë më parë, keni përruar fillimin e zgjerimit të rrugës Prishtinë-Podujevë, përkatësisht, pjesës në mes të fshatrave Gllamnik dhe Lluzhan, në gjatësi prej 4 km. Jeni deklaruar në Maj 2018 se punët planifikohen të kryhen për 200 ditë. Tani që kanë kaluar për afërsisht tre muaj nga fillimi i punimeve, nga dukja e punëve në terren, merret përshtypja se punët kanë ngecur, me që rast po krijohen vështirësi qarkullimi jo vetëm për qytetarët e kësaj ane, mirëpo edhe për bashkëatdhetarët tanë që qarkullojnë në këtë rrugë gjatë rrugëtimit për në vendlindje.

PYETJA: Z. Ministër, a mund të na shpjegoni nëse ky projekt është duke ecur sipas orarit të planifikuar të punimeve? A vlerësoni se projekti në fjalë do të kryhet brenda afateve kohore të parapara në kontratë? Nëse punët kanë ngecur, që duket se po, çfarë hapa do të ndërmerri për të siguruar që operatori ekonomik i ngarkuar me realizimin e këtij projekti të përfundojë punët brenda afateve kohore?